



Data: 18.05.2018

Ref.: 439/MBD

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

### V E N D I M

- I. Përmirësohet vendimi i KSHC-së Ref.:532/17, datë: 06.07.2017, i Universiteti të Gjilanit “Kadri Zeka”.
- II. Përmirësohet emërtimi i programit: Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike në: Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (Program i përbashkët i ofruar nga: Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”).
- III. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së me Ref.:532/17, datë: 06.07.2017, mbetet e pandryshuar.

### A r s y e t i m i

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”, ka parashtruar kërkesë me nr. 713/17, datë: 13.10.2017, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), për përmirësim të vendimit të KSHC-së, me Ref.:532/17, datë: 06.07.2017.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe kontrollimit të aplikacionit të dorëzuar nga Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”, për programin e lartshënuar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”;
- Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”;
- Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

